

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVO

P.nr.1505/15

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM  
ODLIKA JE PRAVNOSNAZNA  
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD  
FERIZAJ I UROSEVAC

NË EMËR TË POPULLIT

24-05-2018  
GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, në përbërje nga gjyqtarja individual Hakile Ilazi si dhe zyrtaren ligjore Ganimete Avdiu, në çështjen penale kundër të akuzuarit [REDAKTUAR], për shkak të veprës penale heqja apo dëmtimi i vulave ose i shenjave nga neni 414 të KPRK-së sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.II.nr.2234-4/14 të datës 02.12.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik, në praninë e përfaqësuesit të akuzës prokurores së shtetit Sebahate Sinani, të pandehurit dhe mbrojtësit të tij av. [REDAKTUAR] me datë 22.08.2017 mori dhe publikisht komunikoi, ndërsa me dt.05.09.2017 përpiloi me shkrim këtë:

#### AKT GJYKIM

I akuzuari [REDAKTUAR] nga Shtimja rr. [REDAKTUAR], pronar i objektit afarist [REDAKTUAR], i lindur më [REDAKTUAR] në të njëjtin vend, nga i ati [REDAKTUAR] e ëma [REDAKTUAR] e gjinisë [REDAKTUAR], i martuar baba i katër fëmijëve, me profesion laborant, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

#### ËSHTË FAJTOR

Sepse me datën 15.08.2014 rreth orës 15:25, në rr. "Adem Jashari" në Shtime përkatësisht në lokalit e lojërave te fatit [REDAKTUAR] të cilën e menaxhon i pandehuri, ka dëmtuar shenjen zyrtare të vendosur nga ana e Policisë dhe Administratës Tatimore të Kosovës me qëllim të sigurimit të atij lokalit, në atë mënyrë që ka hapur objektin e siguruar dhe ka vazhduar veprimtarinë në mënyrë të kundërligjshme.

-më këtë ka kryer veprën penale heqja apo dëmtimi i vulës ose shenjave nga neni 414 të KPRK-së.



Andaj, gjykata në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 4,7,17,21, 43,46 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPRK-së, të pandehurin e

### **G J Y K O N**

**Me dënim me gjobë në lartësi prej 500 /pesë qind / € të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afat prej 30 dite nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.**

**Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyra tjera të parapara në nenin 46 të KPRK-së, i njëjti do ti shndërrohet në dënim burgu ashtu që për çdo 20 euro, do ti llogaritet 1(një) ditë burg.**

**Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor, të paguajë shumën 30 /tridhjetë/€ në afatin prej 30 ditëve nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.**

### **A r s y e t i m i**

Prokuroria Themelore në Ferizaj ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.2234-4/14 të datës 02.12.2015 më të cilat ka ngarkuar të akuzuarin [REDAKTUAR] për shkak të veprës penale heqja apo dëmtimi i vulave ose shenjave nga neni 414 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale me datë 22.08.2017 mbajti shqyrtimin gjyqësor, në të cilën përfaqësuesi i akuzës – prokurorja e shtetit Sebahate Sinani në fjalën përfundimtare ka mbet në tërësi pranë akuzës, njëherit ka kërkuar nga gjykata të njëjtin ta shpall fajtor dhe ti shqiptohet dënimi i paraparë me ligj për këtë vepër penale.



Mbrojtësi i autorizuar të akuzuarit [REDAKTUAR] Av [REDAKTUAR] në fjalën përfundimtare ka deklaruar se me asnjë provë fakt apo argument nuk është vërtetuar dhe konstatuar se i pandehuri [REDAKTUAR] ka kryer veprën penale për të cilën prokuroria e shtetit ja vë në barrë. Nga dëshmia e dëshmitarëve nuk është vërtetuar dhe konstatuar se i pandehuri ka kryer këtë vepër penale andaj presim nga kjo gjykatë të sjell një aktgjykim të drejt dhe të ligjshëm dhe të besueshëm i cili për klientin tim do të jetë aktgjykim lirues sepse jemi të bindur se nuk është paraqitur asnjë provë që do të vërtetonte pretendimet e prokurorisë së shtetit.

I akuzuari [REDAKTUAR] në shqyrtimin fillestar, si dhe në shqyrtimin gjyqësor është deklaruar i pa fajshëm për veprën penale heqja apo dëmtimi i vulave ose shenjave nga neni 414 të KPRK-së, me të cilën është ngarkuar, në mbrojtjen e tij ka deklaruar se pasi ka bërë kërkesën dhe ka marrë pëlqimin për zhvendosjen e këtij lokali, ka hequr blloben me lejen e punëtorëve të autorizuar të komunës, për të cilin rast ju kishte shqiptuar gjoba nga prej 1000/një mijë euro/ nga inspektoret e ATK-së, me të cilin rast e kishte paguar gjobën dhe njëkohsisht kishte marrë lejen për zhvendosjen e lokalit dhe hapjen e lokalit të ri me një lartësi prej 500m larg objekteve shkollore dhe fetare.

Gjykata pas administrimit të provave në shqyrtim gjyqësor dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat e tjera, ku në bazë të këtij vlerësimi vërtetohet gjendjen e fakteve si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me datën 15.08.2014 rreth orës 15:25, në rr. "Adem Jashari" në Shtime përkatësisht në lokalin e lojrave të fatit "[REDAKTUAR]" të cilën e menagjon i pandehuri, ka dëmtuar shenjen zyrtare të vendosur nga ana e Policisë dhe Administratës Tatimore të Kosovës me qëllim të sigurimit të atij lokalit, në atë mënyrë që ka hapur objektin e siguruar dhe ka vazhduar veprimtarinë në mënyrë të kundërligjshme.

Gjendjen faktike gjykata e vërtetoi nga dëshmitë e dëshmitarëve - [REDAKTUAR]  
[REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR]



Nga dëshmia e të dëshmitarit – [REDAKTUAR] vërtetohet se lokali i lojërave [REDAKTUAR] të sheshi i [REDAKTUAR] ka qenë subjekt afarist i regjistruar, me rastin e kontrollit, i kishin dhënë vërejtje që të largohet në ndonjë lokal tjetër në largësi 500 metra larg institucioneve arsimore dhe fetare, me datën 15.08.2014 kishin vendosur drynin dhe shiritin e ATK-së të cilat konsiderohen shenja zyrtare, kjo mbyllje ka qenë mbyllje e përkohshme deri sa të bëhet largimi në ndonjë objekt tjetër në largësinë e paraparë. Me datë 20.08.2014 ka qenë kontrolli e dytë për arsye që të shikohet e a janë larguar siç kanë kërkuar, të njëjtit kishin vërejtur se dryni ka qenë i thyer dhe blloba e larguar, me atë rast kishin hartuar procesverbalin për ndërrimin dhe vendosjen e një dryni tjetër të cilin e kishin vendosur vetë pronari i këtij lokali të lartcekur dhe pasi kishin nënshkruar procesverbalin për fillim të hetimit një punëtor i të pandehurit [REDAKTUAR] me emrin [REDAKTUAR] kishte kërkuar që t'ia hapim lokalin për tërheqjen e pajisjeve pasi që kanë vendosur drynin e dytë, pas hartimit të procesverbalit të datës 20.08.2017 ka qenë detyrë e tyre që të bëjmë një fletëparaqitje për fillimin e hetimit kundër [REDAKTUAR]

Nga dëshmia e dëshmitarit [REDAKTUAR] vërtetohet se më datë 15.08.2014 nuk ka qenë personalisht në kontroll, ndërsa me dt. 20.08.2014 ka qenë me inspektoren e licencimit [REDAKTUAR], aksioni ka qenë i organizuar prej inspektoriatit të shërbimeve publike në Shtime, në këtë rast detyra e tij ka qenë verifikimi i pikave që kanë qenë të mbyllura me dt. 15.08.2014, po nga ky institucion, ndërsa me dt 20.08.2014 kemi kishin konstatuar në bazë të raportit që e posedoj sipas këtij institucioni se këto subjekte nuk mundën të ushtrij veprimtarin brenda zonës qendër të cilat gjenden afër institucioneve fetare, komunale të cilat duhet të transferohen në lokacionet ku mund të ushtrij në veprimtarin në bazë të ligjit nr. 04-L-080. Pas mbyllje se këtyre lokaleve me datën e cekur me lart dhe sipas (inspektorëve komunal) se këto biznese prapë ushtrij në veprimtarin të cilat i kanë monitoruar lokalet e mbyllura, vërtetohet se pronaret e këtyre subjekteve kanë bërë hapjen e tyre dhe kanë zhvilluar veprimtarin e tyre në mënyrë të kundërligjshme andaj me rastin e vizitës me dt 20.08.2014, lokali ka qenë i mbyllur është fjala për lokalin në rr. [REDAKTUAR] në Shtime, Subjekti [REDAKTUAR] apo [REDAKTUAR], dyshohet se kishte hjekur shiritin për mbylljen e lokalit prandaj në bazë të nenit 77 pika 1.1 të ligjit nr. 04-L-80 subjekti ndëshkohet me gjobe në vlerë 1000 euro, subjekti ka



ushtruar veprimtarin në kundërshtim me ligjin në fuqi, arsyeja e shqiptimit të gjobës ka qenë dyshimi se në këtë lokal është ushtruar veprimtaria pasi kishte hjekur shiritin por në momentin e vizitës që kishin bërë me ekipin lokal ka qenë i mbyllur dhe ju është vendos edhe një shirit në lokalin, Rr, [REDACTED] është te lokali nr. [REDACTED] te udhëkryqi ku edhe e kemi shqiptuar gjobën, ne baze te dhënave te inspektorëve, pronar ka qen [REDACTED] ndërsa sa i përket pikës nr. [REDACTED] e ne rr, e [REDACTED] dhe nuk e dimë se kush ka qenë pronar, gjoba është shqiptuar se lokali ka qene brenda zonës ku ka qene e ndaluar sipas ligjit qe mos te jenë afër objekteve fetare mirëpo i njëjti e ka zhvendos këtë lokal Prishtinë Lipjan (rr [REDACTED]) dhe ka qenë i licencuar, sa i përket pikës ne rr. [REDACTED] i njëjti ka pas licencë dhe kishte shkuar pasi e kishin mbyllur piken [REDACTED] me pronar [REDACTED]

Nga dëshmia e Dëshmitari [REDACTED] vërtetohet se lokali i [REDACTED] [REDACTED] [REDACTED] nga ATK- së, e kishin mbyllur dy ditë, deri sa e kemi marr licencën, për këto dy dite ne nuk kishin punuar n' lokalin e lojrave të fatit në rr. [REDACTED] në Shtime, Subjekti [REDACTED], gjate asaj kohe [REDACTED] nuk kishte pas pik tjetër te lokaleve, lokali pas mbylljes është hap pas dy dite pasi qe e kemi marr licencën nga ATK-ja, sa i përket këtij lokali te [REDACTED] po i kemi respektuar dhe e kemi bërë licencimin dhe po ashtu kemi marr edhe pëlqimin nga komuna e Shtimes për zhvendosje ne periferi. Dëshmitari ka potencuar edhe faktin se punon tek [REDACTED] dhe në vitin 2014 ka qenë [REDACTED] pronar, ne atë rr. [REDACTED] ka qen vetëm një lokal, dhe ka qenë pika [REDACTED] tjetër lokal nuk ka pasur dhe i njëjti nuk ka pas njohuri për ndonjë lokal tjetër, lokali ishte mbyllur për zhvendosje prej kësaj pjese te qytetit, nga inspektorët e ATK – së, gjithashtu ka theksuar se nuk ka pas njohuri qe është hap ky lokal deri sa kemi kaluar ne rr. [REDACTED] dhe se i njëjti nuk ka pas lokal që kam marr në shfrytëzim personalisht por ka qenë punëtor në lokalin ku ka qenë pronar [REDACTED].

Dëshmia e dëshmitarëve [REDACTED] dhe [REDACTED] në përgjithësi konsiderohet e besueshme pasi që i njëjtit ka përshkruar ngjarjen në mënyrë të detajuar dhe kronologjike. Gjithashtu dëshmia përputhet edhe me Procesverbalet nga sektori – inspektori i ATK-se me nr 000110 dhe nr. 000114 si dhe fotografit te cilat gjenden ne shkresat e lendes.



Dëshmia e dëshmitarit [REDAKTUAR] në përgjithësi konsiderohet e besueshme dhe bindëse pasi që i njëjti e përshkruante ngjarjen në mënyrë logjike dhe këto aspekte i japin shkallë besueshmërie së këtyre dëshmimeve.

Gjykata dëshmisë së këtyre dëshmitarëve ia shprehi besimin e plotë, pasi që e njëjta është e mbështetur në prova dhe fakte të cilat janë administruar në cilësinë e provës siç janë

- Procesverbalet nga sektori –inspektori i ATK-se me nr 000110 dhe nr. 000114 si dhe
- fotografit të cilat gjenden në shkresat e lëndës.
- Raporti nga inspektori komunal Shtime , nga ATK-ja , Dogana dhe policia e Shtimes të lokalit [REDAKTUAR] dhe Lokali ‘ [REDAKTUAR] ’

Gjykata me kujdes të veçant vlerësoi mbrojtjen e të akuzuarit [REDAKTUAR] dhe tezen e mbrojtësit të tij av [REDAKTUAR] se nuk e ka kryer veprën penale. Por gjykata vlerëson pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit janë të pa qëndrueshme.

Në bazë të gjitha provave të rastit dhe në bazë të deklarimeve të dëshmitarit ka vërtetuar gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, dhe se vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit manifestohen të gjitha tiparet e veprës penale heqja apo dëmtimi i vulave ose i shenjave nga neni 414 të KPRK –së, pa si që i akuzuari ka dëmtuar shenjen zyrtare të vendosur nga ana e Policisë dhe Administratës Tatimore të Kosovës me qëllim të sigurimit të atij lokalit, në atë mënyrë që ka hapur objektin e siguruar dhe ka vazhduar veprimtarinë në mënyrë të kundërligjshme, nga aspekti subjektiv i akuzuari veprën penale të kryer me dashje direkte pasi që ka qenë i vetëdijshëm për veprimet e tij dhe njëkohësisht ka dëshiruar ardhjen e pasojave.

Pjesën e mbrojtësit të akuzuarit se nuk ka dëmtuar bllobën dhe se ka hekur bllobat pasi që ka marrë pëlqimin për zhvendosjen e këtij lokalit, gjykata vlerësoi si të pa qëndrueshëm dhe të orientuar në justifikimin e veprimeve inkriminuese, duke pasur



parasysh faktin se i akuzuari ishte pronar i lokalit dhe kishte kontrollin e plotë mbi të, me të cilën rrjedhimisht objektivisht ka qenë në dijeni mbi gjendjen e lokalit të tij.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit pati parasysh të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPRK-së, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, si rrethana lehtësuese gjykata morri është baba i katër fëmijëve, përkatësisht mbajtës i familjes, ndërsa rrethana veçanërisht rënduese mori peshën e veprës penale dhe rrezikshmërinë e saj,

Në bazë të këtyre rrethanave gjykata i caktoj dënim si në dispozitiv të aktgjykimit, duke qenë e bindur se një dënim i tillë është plotësisht i justifikueshëm dhe në proporcion me peshën e veprës konkrete penale, rrethanave të kryerjes si dhe personalitetit e të pandehurit, dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi ndëshkues në kuptim të preventivës speciale që i pandehuri në të ardhmen të mos kryejë vepra penale, si dhe në kuptim të preventivës së përgjithshme të parandalimit të përgjithshëm të kësaj veprë penale në shoqëri.

Vendimi mbi paushallin gjyqësor është marrë konform nen. 450 dhe 451 të KPPRK-së, dhe Gjykata e ka obliguar të pandehurin që të paguaj paushallin gjyqësor në shumën prej 30 €, në afat prej 30 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbartimit me dhunë.

Nga arsyet e cekura më lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
P.nr.1505/15 të dt. 05.09.2017

Zyrtare ligjore,  
Ganimete Avdiu



Gjyqtarja,  
Hakile Ilazi

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit Kosovës. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.